



**Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave
në Shqipëri: Krahasimet e të dhënave
nga vitet 2007, 2013 deri në vitin 2018**




Empowered lives.
Resilient nations.

PËRMBLEDHJE STUDIMI¹

Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri: Krahasimet e të dhënave nga vitet 2007, 2013 deri në vitin 2018

Qershor 2019

1. Ky vërtetim u krye nga INSTAT, me ekspertizën teknike të ofruar dhe shkrimin e raportit të kryesuar nga Dr. Robin Haarr, konsulente ndërkombëtare, me mbështetjen e UNDP-së dhe UN Women dhe me ndihmën financiare të Qeverisë së Australisë, në kuadër të projektit rajonal për statistikat gjinore dhe të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm “Të bëjmë çdo grua dhe vajzë të ketë rëndësi”, dhe të Qeverisë Suedeze, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund Dhunës ndaj Grave në Shqipëri”. Opinione dhe mendimet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e UNDP-së, UN Women dhe/ose të donatorëve të tyre.



HYRJE

Dhuna ndaj Grave (DhNG) është një shkelje e përhapur e të drejtave të njeriut dhe një problem global i shëndetit publik me përmasa epidemike. DhNG-ja pranohet edhe si shkak edhe si pasojë e pabarazisë gjinore dhe është një pengesë kryesore që gratë dhe vajzat të gëzojnë të drejtat e njeriut dhe që ato të marrin plotësisht pjesë në shoqëri dhe ekonomi.

Nuk ka një faktor të vetëm që shkakton DhNG-në; përkundrazi, ka disa elementë që veprojnë në nivele të ndryshme të "ekologjisë sociale", të cilët përjetësojnë dhe përforcojnë qëndrimet, normat dhe praktikatat diskriminuese dhe paragjyquese gjinore, të cilat kontribuojnë në pabarazinë e përhapur të pushtetit mes burrave dhe grave në shoqëri dhe në DhNG.

DhNG-ja shfaqet në forma të ndryshme të dhunës fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike, e cila ndodh në hapësira publike dhe private. DhNG-ja shkatërron shëndetin mendor dhe fizik si edhe mirëqenien e grave

e vajzave dhe mund të ketë një efekt negativ në sigurinë, stabilitetin dhe paqen e tyre afatgjatë. DhNG-ja ka gjithashtu ndikim serioz në zhvillimin dhe avancimin e grave si edhe në kontributin që ato japin në ekonomi.

DhNG-ja nuk është një fenomen i ri në Shqipëri. Ajo i ka rrënjët thellë në traditat dhe zakonet patriarkale të cilat i kanë dhënë formë Shqipërisë prej kohësh, përfshirë identitetet dhe rolet e ngurta gjinore, autoritetin patriarkal, respektimin e sistemit të nderit dhe turpit, zakonet e urdhrave hierarkike brenda familjes si edhe kontrollin midis brezave në familje.

VROJTIMET ME BAZË POPULLATËN PËR DHUNËN NDAJ GRAVE NË SHQIPËRI

DhNG-ja është një problem i ndjeshëm, gjë që e bën mbledhjen e të dhënave mbi përhapjen e saj një proces kompleks. Kjo ndodh sepse një pjesë e madhe e dhunës që përjetojnë gratë ndodh prapa dyerve të mbyllura dhe ushtrohet nga partnerët intimë të tyre, anëtarët e familjes dhe/ose nga burrat me të cilët ato dalin për t'u njohur. Të mbijetuarat nga DhNG-ja shpesh ngurrojnë ose kanë frikë të raportojnë rastet e dhunës, për shkak të frikës së shpagimit nga dhunuesi(t) i/e tyre dhe/ose nga reagimet negative të familjes dhe miqve. Femrat që flasin dhe ngrenë zërin ose kërkojnë ndihmë për DhNG-në shpesh fajësohen për viktimizimin e tyre. Për këto arsye, gratë zakonisht nuk e bëjnë të njohur në mënyrë spontane një histori dhune.

Pavarësisht sfidave në mbledhjen e të dhënave, INSTAT-i ka kryer tri vrojtime kombëtare me bazë popullatën për DhNG-në në Shqipëri. Me asistencën teknike dhe mbështetjen e UNDP-së dhe UNICEF-it, INSTAT kreu Vrojtimin e parë Kombëtar për Dhunën në Familje (VKDhF) në vitin 2007. Në vitin 2013, me asistencë teknike nga UNDP-ja dhe mbështetje financiare nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), INSTAT kreu VKDhF-në e 2-të. Vrojtimi Kombëtar për Dhunën ndaj Grave i vitit 2018 (VKDhNG) ishte vrojtimi i 3-të me bazë popullatën.

Me kalimin e viteve, INSTAT-i ka përdorur sistematikisht standarde ndërkombëtare për të mbledhur të dhëna për DhNG-në dhe pasojat negative të DhNG-së mbi gratë dhe fëmijët e tyre, si edhe për sjelljet ndihmë kërkuese të të mbijetuarave nga DhNG-ja. VKDhNG-ja e vitit 2018 mati gjithashtu normat shoqërore që lidhen me DhNG-në, si edhe perceptimet e grave në lidhje me ashpërsinë e DhNG-së në Shqipëri dhe

rëndësinë e legjislacionit për DhNG-në.

Për të matur përhapjen e DhNG-së, këto studime kanë përdorur metodologji dhe pyetësorë të standardizuar të krijuar nga studimi shumëkombësh i OBSH-së mbi shëndetin e grave dhe dhunën në familje dhe modelet e Agjencisë së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (ADTh) për studimin e dhunës ndaj grave. Në përputhje me ADTh-në, u morr vendimi që në rastin e VKDhNG-së të vitit 2018 kampionët të ishin gratë deri në moshën 74 vjeçare, ndryshe nga VKDhF-ja e vitit 2013, e cila mbajti si kufirin më të lartë moshën 55 vjeç dhe ajo e 2007-s e cila mbajti si kufi limit moshën 49 vjeç. Në VKDhNG-në e vitit 2018, masat e normave dhe qëndrimeve shoqërore lidhur me DhNG-në u bazuan në literaturën ndërkombëtare për matjen e normave shoqërore dhe në pyetje dhe masa të standardizuara që ishin përdorur në një studim të vitit 2018 për normat shoqërore të DhNG-së dhe praktikat e dëmshme në Malavi, kryer nën kujdesin e UN Women Malavi.²

Secili prej vrojtimeve kombëtare me bazë popullatën, i vitit 2007, 2013 dhe 2018, u krye me përdorimin e metodave dhe instrumenteve për mbledhje të dhënash të ngjashme por jo të njëjta. Ka pasur disa dallime dhe ndryshime të mëdha që janë bërë përgjatë viteve (shih tabelën 1). Prej tyre, më i madhi ka qenë se vrojtimi i 1-rë përfshinte kampion grash të moshave 15-49 vjeç dhe fëmijë të moshave 10-14 vjeç, ndërsa vrojtimi i 2-të përfshinte vetëm gratë e moshave 18-55 vjeç dhe vrojtimi i 3-të përfshinte gratë e moshave 18-74 vjeç. Gjithashtu, llojet e DhNG-ve që mateshin u zgjeruan ndjeshëm në vitin 2018 për të përfshirë jo vetëm dhunën në familje të ushtruar nga partnerët intimë përjetuar

2. Haarr, R.N. (2018). *Perceptimet e Normave Shoqërore të Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave dhe praktikat e Dëmshme në Malavi*. UN Women: Lilongwe, Malavi.

Tabela 1. Vrojtimet kombëtare për dhunën në familje dhe DhNG-në në Shqipëri të kryera nga INSTAT-i

	VKDhF-ja e 1-rë (2007)	VKDhF-ja e 2-të (2013)	VKDhNG-ja e 3-të (2018)
Kampioni	12 Prefektura	12 Prefektura	12 Prefektura
Madhësia e kampionit	Gra, N=2590 Fëmijë, N=991	Gra, N=3589	Gra, N=3443
Shpërndarja demografike e kampionit	Gra, mosha 15-49 Fëmijë, mosha 10-14	Gra, mosha 18-55	Gra, mosha 18-74
Llojet e DhNG-ve të matura	Dhuna në familje e ushtruar nga partneri intim përjetuar nga gratë (dhunë emocionale, psikologjike, fizike dhe seksuale)	Dhuna në familje e ushtruar nga partneri intim (dhunë psikologjike, fizike dhe seksuale) ¹	Dhuna në familje e ushtruar nga partneri intim (sjellje kontrolluese shtrënguese dhe dhunë ekonomike, psikologjike, fizike dhe seksuale)
	Dhuna në familje e përjetuar nga fëmijët (dhunë psikologjike dhe fizike)	Dhuna nga jopartneri e përjetuar nga gratë që nga mosha 15-vjeçare (fizike)	Dhuna gjatë marrëdhënies dashurore (sjellje kontrolluese shtrënguese dhe dhunë ekonomike, psikologjike, fizike dhe seksuale)
			Dhuna nga jopartneri e përjetuar nga gratë që nga mosha 15-vjeçare (dhunë fizike dhe seksuale)
			Ngacmimi seksual
			Përndjekja
			Normat dhe qëndrimet shoqërore që lidhen me DhNG-në

¹ Shënim: Dhuna emocionale dhe psikologjike u matën në vitin 2013 duke përdorur të njëjtat njësi matjeje si në vitin 2007. Megjithatë, ato nuk u ndanë në kategori më vete gjatë analizës, siç u ndanë në vitin 2007.

nga gratë (ato që ishin të martuara ose kishin qenë të martuara dhe/ose jetonin me një partner), por edhe dhunën gjatë marrëdhënies dashurore (përjetuar nga gratë të cilat nuk kishin qenë asnjëherë të martuara dhe nuk kishin jetuar asnjëherë me partner mashkull, por që kanë qenë të përfshira në marrëdhënie me një mashkull pa jetuar së bashku), dhunën nga jopartneri, ngacmimet seksuale dhe përndjekjen, si edhe normat dhe qëndrimet shoqërore që lidhen me DhNG-në. Është e rëndësishme të vërehet se matja e dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim u modifikua dhe u zgjerua nga VKDhF-ja e 2-të në VKDhNG-në e 3-të

Nuk ka një mënyrë të vetme për të matur shkallët e përhapjes së DhNG-së dhe ka një mori instrumentesh për mbledhjen e të dhënave që kanë treguar se janë të vlefshme dhe të besueshme për matjen e shkallës së përhapjes së DhNG-së. Gjithsesi, të dhënat dhe

gjetjet ndërsektoriale nga VKDhF-ja e vitit 2007, VKDhF-ja e vitit 2013 dhe VKDhNG-ja e vitit 2018 mund të krahasohen dhe duhet të krahasohen sepse ato mundësojnë përlogaritje për gamën e grave që përjetojnë dhunë. Kështu, secili nga vrojtimit: VKDhF-ja e vitit 2007, VKDhF-ja e vitit 2013 dhe VKDhNG-ja e vitit 2018 shërbejnë për të ndihmuar qeverinë, partnerët për zhvillim dhe organizatat e shoqërisë civile të kuptojnë më mirë DhNG-në në Shqipëri, për të monitoruar modelet dhe tendencat gjatë viteve dhe për të hetuar ndikimin e politikave, planeve të veprimit të hartuara kohët e fundit dhe nismave për parandalimin, ndërhyrjen dhe mbrojtjen në lidhje me përhapjen e DhNG-së dhe sjelljet ndihmë kërkuese të grave. Të dhënat dhe gjetjet nga këto studime mund të informojnë hartimet e ligjeve dhe politikave, mund t'u japin formë përpjekjeve për parandalim dhe ndërhyrje dhe mund të përmirësojnë mbrojtjen dhe mbështetjen për të mbijetuarat e DhNG-së dhe fëmijët e tyre.

SHKALLËT E PËRHAPJES SË KAMPIONËVE TË NDRYSHËM ME BAZË POPULLATËN

Kjo përmbledhje studimi përbën një hap të rëndësishëm në monitorimin e modeleve dhe tendencave në përvojat e grave me dhunën në familje të ushtruar nga partnerë intimë dhe dhunën nga jopartnerë që nga moshën 15-vjeçare, si edhe në lidhje me sjelljet ndihmë kërkuese nga të mbijetuarat e DhNG-së bazuar në të dhëna të siguruara nga VKDhF-të e viteve 2007 dhe 2013 dhe nga VKDhNG-ja e vitit 2018.

KRAHASIMI I TË DHËNAVE MBI DHUNËN NË FAMILJE TË USHTRUAR NGA PARTNERI INTIM (2007, 2013 DHE 2018)

Në rang global, forma më e përhapur e DhNG-së është dhuna e ushtruar nga partneri intim (DhPI). DhPI-ja është manifestim i pabarazive gjinore që ekzistojnë në marrëdhëniet intime, në familje dhe në shoqërinë e gjerë. Ndonëse DhPI-ja ekziston në të gjitha shoqëritë, shoqëritë me praktika dhe stereotipe tradicionale më patriarkale në lidhje me rolet gjinore priren të kenë shkallë më të lartë të DhPI-së. Në vendet ku praktikant kulturorë diktojnë që gratë të lënë shtëpinë dhe familjen ku janë lindur për të jetuar me bashkëshortin dhe familjen e tij, përforcojnë më tej izolimin e grave nga familja e tyre e lindjes dhe i vendosin ato në risk më të lartë për dhunë martesore. Në situata të tilla, autorët e dhunës martesore nuk janë vetëm bashkëshortët, por mund të jenë edhe njerëzit e tyre, veçanërisht vjehrra dhe kunatat. Kjo është më e theksuar në familje ku gratë e sapomartuara vendosen në pozicionin më të ulët brenda familjes ku ato martohen.

Format e përhapura të dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim përfshijnë dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike. Studimet ndërkombëtare kanë konstatuar se shumica e grave që përjetojnë dhunë në

marrëdhënie intime shpesh përjetojnë forma të shumëfishta dhune dhe durojnë vepra të përsëritura dhune nga bashkëshorti/partneri aktual dhe/ose ish-bashkëshorti/partneri. Në kontekstin e martesës, dhuna seksuale mund të mos njihet ose përkufizohet si e tillë për shkak të supozimeve se bashkëshortët janë të përligjur të detyrojnë gratë e tyre të kryejnë marrëdhënie seksuale dhe se gratë janë të detyruara të kënaqin seksualisht nevojat seksuale të bashkëshortëve të tyre. Në shumë vende ka një ngurrim për t'i përcaktuar aktet seksuale me detyrim në situata martesore si dhunë seksuale ose përdhunim martesor. Megjithatë, Shqipëria ka ligje që adresojnë përdhunimin martesor dhe parashikojnë ndëshkime më të ashpra ndaj autorëve të përdhunimit martesor, i cili tashmë konsiderohet vepër penale më vete.

Në shumë shoqëri besohet se ka "arsye të përligjura" për dhunën në familje nga partneri intim, sidomos kur gratë nuk përmbushin pritshmëritë për rolet e tyre gjinore (p.sh. gruaja djeg gjellën, bën fjalë me bashkëshortin, del pa i thënë atij, lë pas dore fëmijët ose nuk pranon të kryejë marrëdhënie seksuale me bashkëshortin e saj). Në këto rrethana që supozohen si të përligjura, gratë fajësohen për viktimizimin e tyre, gjë që e bën të vështirë që ato të flasin e të ngrenë zërin dhe të kërkojnë ndihmë e mbrojtje nga bashkëshortët/partnerët e tyre dhunues. Studimet ndërkulturore tregojnë se në shumë shoqëri, si burrat edhe gratë, të rinjtë e të moshuarit, pajtohen me qëndrimet kulturore dhe normat shoqërore që përligjin rrahjen e gruas.

Përveçse pranohet në kulturën e shumë shoqërive, dhuna në familje e ushtruar nga partneri intim mbetet në një masë të madhe e fshehtë pas dyerve të mbyllura dhe tejet e stigmatizuar, duke ua bërë të vështirë grave



të flasin për të dhe të kërkojnë ndihmë e mbrojtje. Gratë që përjetojnë dhunë në familje të ushtruar nga partneri intim shpesh ndihen se nuk kanë kujt t'i drejtohen, veçanërisht në shoqëri ku shërbimet mbështetëse janë të kufizuara dhe është e vështirë që gratë t'i lënë bashkëshortët/partnerët e tyre dhe të jetojnë vetëm. Në shoqëri me shkallë të lartë dhune në familje të ushtruar nga partnerë intimë, vajzat mësojnë në moshë të vogël se nuk duhet të kundërshtojnë abuzimin dhe dhunën, duke u mësuar ta shohin dhunën ndaj grave të bëhet diçka normale në familjet e tyre.

Gjetjet nga VKDhNG-ja e vitit 2018, VKDhF-të e viteve 2013 dhe 2007 konfirmojnë se dhuna ndaj grave në familje e ushtruar nga partneri intim është e përhapur në familjet dhe komunitetet në gjithë Shqipërinë. Nisur nga fakti se këto tri studime përdorën metodologji dhe instrumente të ngjashme për mbledhjen e të dhënave në lidhje me dhunën në familje

të ushtruar nga partneri intim, mund të bëhen krahasime. Megjithatë, duhet pasur parasysh se janë bërë disa modifikime në VKDhNG-në e vitit 2018 në përpjekje për të matur më shumë lloje të dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim se sa ato që u matën në VKDhF-në e vitit 2013 dhe VKDhF-në e vitit 2007. U hoqën ose u ndryshuan disa pyetje nga VKDhF-ja e vitit 2013 dhe e vitit 2007 si dhe u shtuan disa pyetje të tjera.

Tabela 2 tregon se VKDhNG-ja e vitit 2018 konstatoi se 47,0% e grave të moshës 18-74 vjeç që ishin martuar dhe/ose jetonin me një partner kishin përjetuar një ose disa prej pesë llojeve të dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim (sjellje kontrolluese, dhunë ekonomike, dhunë psikologjike, dhunë fizike dhe/ose dhunë seksuale) në jetën e tyre dhe 33,7% kishin përjetuar një ose disa nga pesë llojet e dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim në 12 muajt përpara intervistës. Më konkretisht, 21,0%

Tabela 2. Dhuna në familje e ushtruar nga partneri intim ndaj grave në Shqipëri (2007, 2013 dhe 2018)

	2018 Gratë, 18-74 vjeç, ndonjëherë të martuara/që kanë jetuar me një partner		2013 Gratë që kanë pasur ndonjëherë partner, moshë 18-55 vjeç		2007 Gratë që kanë pasur ndonjëherë partner, moshë 15-49 vjeç
	Aktualisht	Ndonjëherë	Aktualisht	Ndonjëherë	Aktualisht
Kanë përjetuar dhunë në familje të ushtruar nga partneri intim (një ose disa prej 5 llojeve)	47.0%	33.7%	59.4%	53.7%	56.0%
Sjellje kontrolluese shtrënguese	41.2%	25.2%	51.4%	45.4%	Nuk disponohet
Dhunë ekonomike	7.0%	7.0%	10.4%	8.6%	Nuk disponohet
Dhunë psikologjike	31.4%	19.7%	58.2%	52.8%	58.2%
Dhunë fizike	18.0%	7.2%	23.7%	14.7%	23.7%
Dhunë seksuale	8.6%	3.6%	7.9%	5.0%	7.9%
Kanë përjetuar dhunë në familje fizike dhe/ose seksuale të ushtruar nga partneri intim	21.0%	8.2%	24.6%	16.2%	Nuk disponohet

e grave të moshës 18-74 vjeç kishin përjetuar “ndonjëherë” dhe 8,2% “aktualisht” dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja, të ushtruar nga bashkëshortët/partnerët e tyre. VKDhF-ja e vitit 2013 zbuloi se te gratë e moshës 18-55 vjeç që kishin pasur ndonjëherë partnerë, 59,4% e grave kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë nga partneri intim dhe 53,7% e grave kishin përjetuar dhunë nga partneri intim në 12 muajt përpara kryerjes së vërtetimit. Më konkretisht, 24,6% e grave të moshës 18-55 vjeç kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike dhe/ose seksuale të ushtruar nga partneri intim dhe 16,2% kishin përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja, në 12 muajt përpara kryerjes së vërtetimit. VKDhF-ja e vitit 2013 nuk bënte dallim mes dhunës në familje nga partneri intim dhe dhunës gjatë marrëdhënies dashurore, siç u bë në këtë studim. Krahasimisht, VKDhF-ja e vitit 2007 konstatoi se 56,0% e grave të moshës 15-49 vjeç kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë në familje të ushtruar nga partneri intim. Më konkretisht, 58,2% e grave kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë psikologjike, 23,7% kishin përjetuar dhunë fizike dhe 7,9% kishin përjetuar dhunë seksuale.

Gjetjet nga këto tri studime japin përllogaritje të përmasave të numrit të grave që përjetojnë dhunë të ushtruar nga partneri intim. Në varësi të kampionit, duke përfshirë moshën e grave të përfshira në kampion, përhapja e dhunës në familje e ushtruar nga partneri intim mund të variojë dhe matje të ndryshme të dhunës mund të rezultojnë në shkallë të ndryshme përhapjeje. Duke pasur parasysh rritjen në kufirin e sipërm të moshës së grave që janë zgjedhur si kampion, deri në 74 vjeç në VKDhNG-në e vitit 2018, u ngrit hipoteza se prania e tyre në kampion do të ndryshonte rezultatet për të treguar ulje në dhunën në familje të ushtruar nga partneri intim aty ku ajo nuk ekziston, veçanërisht nëse të dhënat e VKDhNG-së së vitit 2018 do të krahasoheshin me të dhënat nga VKDhF-ja e vitit 2013. Kjo hipotezë u bazua në supozimin se gratë mbi 55 vjeç shpesh kanë më pak gjasa të kenë përjetuar dhunë në 12 muajt përpara

Vrojtimi i vitit 2013 në të gjithë BE-në tregoi se 22,0% e grave kishin përjetuar dhunë fizike nga dikush, jopartner i tyre, që prej moshës 15 vjeç.

intervistës. Gjatë procesit të shkrimit të analizës dhe raportit, të dhënat u analizuan vetëm për gratë e moshës 18-55 vjeç (njësoj si me VKDhF-në e vitit 2013) për të testuar këtë hipotezë dhe gjetjet treguan se hipoteza ishte e gabuar. Kur u analizuan të dhënat nga VKDhNG-ja e vitit 2018 vetëm për gratë e moshës 18-55 vjeç, përhapja e përvojave aktuale të dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim ra me dy deri në tre pikë përqindje. Bazuar në këto gjetje, mund të bëhen krahasime të shkallës së përhapjes së kampioneve të ndryshme të popullatës nga VKDhF-ja e vitit 2013 me VKDhNG-në e vitit 2018.

KRAHASIMET E TË DHËNAVE PËR DHUNËN NGA JOPARTNERI (2013 DHE 2018)

Ka prova të mjaftueshme për të provuar se gratë dhe vajzat janë në rrezik nga dhuna fizike dhe/ose seksuale nga jopartnerët në kontekstin familjar dhe në shtëpi, si dhe në hapësirat publike. Në vitin 2005, vlerësimet në nivel global të OBSH-së tregonin se 7,2% e grave përjetonin dhunë seksuale nga një jopartner gjatë gjithë jetës së tyre. Vrojtimi i vitit 2013 në të gjithë BE-në tregoi se 22,0% e grave kishin përjetuar dhunë fizike nga dikush, jopartner i tyre, që prej moshës 15 vjeç.

Tabela 3. Përvojat e dhunës nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare (2013 dhe 2018)

	2018		2013
	Ndonjëherë	Aktualisht	Ndonjëherë
Kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare (një ose disa prej 4 llojeve)	18.2%	2.4%	Nuk disponohet
Që në moshën 15 vjeçare, një jopartner i ka gjuajtur, qëlluar me shpullë, goditur ose ka bërë diçka tjetër për t'i lënduar fizikisht (dhunë fizike)	17.3%	2.3%	6.9%
Kanë përjetuar dhunë seksuale nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare (një ose disa prej 3 llojeve)	1.3%	0.1%	Nuk disponohet
Që në moshën 15 vjeçare, një jopartner të ka prekur seksualisht pa dashjen tënde ose ka provuar të të prekë seksualisht, por nuk ka mundur të të detyrojë të kryeni marrëdhënie seksuale	1.3%	0.1%	Nuk disponohet
Që në moshën 15 vjeçare, një jopartner të ka detyruar të kryesh marrëdhënie seksuale pa dëshirën tënde, për shembull duke të kërcënuar, duke të mbajtur me forcë ose duke të vënë përballë një situatë ku nuk mund të kundërshtojë	1.0%	0.0%	Nuk disponohet
Që në moshën 15 vjeçare, të ka detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale kur ishte aq e dehur ose e droguar sa nuk mund të refuzojë	1.1%	0.0%	Nuk disponohet

VKDhF-ja e vitit 2013 dhe VKDhNG-ja e vitit 2018 u përqendruan te dhuna e ushtruar nga jopartnerë përjetuar nga gratë që në moshën 15 vjeç, e ushtruar nga anëtarë të familjes ose të afërm të tjerë si edhe joanëtarë të familjes. Tabela 3 tregon se VKDhNG-ja e vitit 2018 gjeti se ndërmjet gjithë grave të moshës 18-74 vjeç, 18,2% kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë të ushtruar nga jopartnerë që në moshën 15 vjeç (ushtruar nga dikush që nuk ishte bashkëshorti/i dashuri), nga të cilat 17,3% kanë përjetuar dhunë fizike nga jopartneri dhe 1,3% kanë përjetuar dhunë seksuale nga jopartneri gjatë gjithë jetës së tyre, dhe 2,4% kanë përjetuar një ose disa prej katër llojeve të dhunës së ushtruar nga jopartneri në 12 muajt përpara vrojtimit. Vetëm 4,6% e grave kanë kërkuar ndihmë për dhunën nga jopartneri.

Krahasimisht, VKDhF-ja e vitit 2013 tregoi se ndërmjet grave me moshë 18-55 vjeç, 6,9% e

tyre përjetojnë dhunë fizike nga jopartneri; dhuna seksuale nga jopartneri nuk u mat në VKDhF-në e vitit 2013. VKDhF-ja e vitit 2007 nuk mat dhunën fizike ose seksuale nga jopartneri. Të dhënat nga këto tri gjetje tregojnë se asnjë prej studimeve nuk nxjerr shkallë të njëjtë përhapjeje, por ato na bëjnë të kuptojmë se gratë në Shqipëri kanë përjetuar dhunë nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare.

KRAHASIMI I TË DHËNAVE PËR DHUNËN FIZIKE GJATË SHTATZËNISË (2013 DHE 2018)

Ndërmjet grave që kanë qenë ndonjëherë shtatzëna, në VKDhNG-në e vitit 2018 u gjet se 1,1% e grave ishte goditur, ishte qëlluar me shpullë, ishte gjuajtur ose abuzuar fizikisht “ndonjëherë” gjatë shtatzënisë (kjo është e ngjashme me gjetjet e VKDhF-së së vitit 2013 sipas së cilit 1,3% e grave të moshës 18-55 vjeç ishin abuzuar fizikisht gjatë shtatzënisë); gratë

Table 4. Experiences of physical violence during pregnancy (2013 and 2018)

	2018	2013	
	Keni qenë ndonjëherë shtatzënë	Keni përjetuar ndonjëherë dhunë fizike	Keni qenë ndonjëherë shtatzënë
Jeni goditur, qëlluar me shpullë, me shkelm, ose jeni abuzuar fizikisht gjatë shtatzënisë	1.1%	2.3%	1.3%
A ju ka ndodhur gjatë shtatzënisë së fundit?	30.5%		Nuk disponohet
Jeni grushtuar apo shqelmuar në bark gjatë shtatzënisë	10.1%		Nuk disponohet

që kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike në martesën/marrëdhënien e tyre kishin dy herë më shumë gjasa të abuzoheshin gjatë shtatzënisë (2,3%). Ndërmjet grave që ishin abuzuar fizikisht gjatë shtatzënisë, 30,5% ishin abuzuar fizikisht gjatë shtatzënisë së fundit dhe 10,1% ishin grushtuar apo shkelmuar në bark gjatë shtatzënisë. Vetëm 9,0% e grave të moshës 18-74 vjeç kanë kërkuar ndihmë për dhunë në familje të ushtruar nga partneri intim.

Në VKDhNG-në e vitit 2018, gratë që kanë përjetuar dhunë fizike gjatë shtatzënisë janë pyetur kush ka kryer akte dhune ndaj tyre gjatë shtatzënisë. Pesëdhjetë e një për qind e grave raportuan se bashkëshorti/i dashuri aktual ose ish-bashkëshorti/i dashuri i ka gjuajtur, i ka qëlluar me shpullë, i ka shkelmuar ose ka abuzuar fizikisht me to gjatë shtatzënisë. Disa gra kanë raportuar gjithashtu se disa pjesëtarë të tjerë të familjes i kanë gjuajtur, qëlluar me shpullë, me shkelm ose kanë abuzuar fizikisht me to gjatë shtatzënisë. Këtu përfshihen: mamatë/njerkat (4,3%), baballarët/njerkët (4,5%), motrat/vëllezërit (4,3%), vajzat/djemtë (2,5%), të afërm të tjerë (7,3%), vjehrrat (1,6%), vjehrrit (1,6%) dhe të tjerë nga familja e bashkëshortit (2,6%). Çuditërisht, gratë kanë raportuar gjithashtu se edhe persona jo të familjes, përfshirë mësues (7,3%) dhe punëdhënës ose dikush nga puna

(2,5%), i kanë gjuajtur, qëlluar me shpullë ose shkelm ose kanë abuzuar fizikisht me to gjatë shtatzënisë.

Për sa i përket grushtimit ose shkelmimit në bark gjatë shtatzënisë, 79,1% e grave kanë raportuar se ka qenë bashkëshorti/i dashuri aktual ose ish-bashkëshorti/i dashuri që i kanë grushtuar ose shkelmuar në bark gjatë shtatzënisë dhe 10,4% kanë raportuar se një tjetër nga familja e bashkëshortit ka kryer veprë të tillë dhune fizike ndaj tyre gjatë shtatzënisë. Autorët që gjuajnë me grusht ose shkelm në bark një grua shtatzënë nuk sulmojnë vetëm nënën, por synojnë të lëndojnë edhe fëmijën, madje edhe të përfundojnë shtatzëninë.

KRAHASIMET E TË DHËNAVE PËR SJELLJET NDIHMË KËRKUESE (2013 DHE 2018)

Të dhënat kanë treguar se shumica e grave që përjetojnë dhunë në familje të ushtruar nga partneri intim dhe dhunë nga jopartneri nuk kërkojnë ndihmë për dhunën, megjithëse shumica e grave u tregon dikujt rreth përvojës që kanë me dhunën. Shumica e të mbijetuarave nga DhNG-ja vazhdojnë të vuajnë në heshtje pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për të rritur ndërgjegjësimin publik ndaj problemeve të DhNG-së në Shqipëri.

Tabela 5. Sjelljet ndihmë kërkuese ndërmjet grave që kanë përjetuar dhunë në familje dhe dhunë nga jopartneri

	2018		2013	
	Dhuna në familje (ndonjëherë)	Dhuna në familje (aktualisht)	Dhuna në familje (ndonjëherë)	Dhuna e ushtruar nga jopartneri (ndonjëherë)
Kanë kërkuar ndihmë për dhunën	6.7%	9.0%	8.4%	4.6%

Tabela 6. Nga kush kanë kërkuar ndihmë viktimat e dhunës në familje

Familjarë	2018		2013	
	Gratë që kanë kërkuar ndihmë për dhunën në familje	Gratë që kanë kërkuar ndihmë për dhunën në familje	Gratë që kanë kërkuar ndihmë për dhunën nga jopartneri	Gratë që kanë kërkuar ndihmë për dhunën nga jopartneri
Familja ime	98.0%	91.8%	85.3%	
Familja e bashkëshortit/partnerit	40.4%	60.9%	15.5%	
Bashkëshorti/i dashuri aktual / ish-bashkëshorti/i dashuri	4.2%	8.8%	2.6%	
Rrjetet joformale				
Miq	6.7%	29.0%	12.1%	
Fqinjë	11.9%	Nuk disponohet	16.6%	
Udhëheqës fetar	1.7%	0.0%	1.1%	
Rrjetet formale				
Mjeku/punonjësi i institucioneve shëndetësore	3.1%	14.8%	2.6%	
Policia	4.4%	16.8%	8.3%	
Avokati	3.4%	14.8%	2.2%	
Gjyqtari	2.8%	11.2%	4.7%	
Agjencia/organizata e shërbimeve shoqërore	1.6%	11.2%	2.2%	
Strehëza për gratë dhe vajzat	0.4%	Nuk disponohet	0.0%	
Shërbimi i ndihmës (0800 11112)	0.0%	Nuk disponohet	0.0%	
Koordinatori lokal për dhunën në familje	0.0%	Nuk disponohet	0.0%	
Të tjerë	0.0%	Nuk disponohet	2.7%	

Kur gratë kërkojnë ndihmë për dhunë në familje të ushtruar nga partneri intim dhe/ose për dhunën nga jopartneri, shumica e grave kërkojnë ndihmë nga familja e tyre dhe nga rrjete joformale, si për

shembull miq, fqinjë dhe në disa raste nga udhëheqës fetarë; megjithatë, shumë pak gra kërkojnë ndihmë nga burime formale, si për shembull nga agjenci që ofrojnë shërbime për mbështetjen e viktimave, nga

Qeveria duhet të nxisë dhe financojë studimet për përhapjen e DhNG-së me përpjekje të bashkërenduar për të zbuluar informacion në lidhje me përvojat e grave me dhunën në familje të ushtruar nga partneri intim, dhunën gjatë marrëdhënies dashurore, dhunën e ushtruar nga jopartneri, ngacmimin seksual dhe përndjekjen.

sistemi shëndetësor, policia dhe/ose sistemi i drejtësisë. Tabela 5 tregon se numri i grave që kanë raportuar kërkim ndihme për dhunë në familje ishte 8,4% në vitin 2013 dhe shkoi në 6,7% në vitin 2018, por numri i grave që kanë kërkuar ndihmë për dhunën në familje të përjetuar në 12 muajt përpara intervistës ishte 9,0% në vitin 2018.

Tabela 6 tregon se shumica e grave për dhunën në familje dhe dhunën ushtruar nga jopartneri kanë kërkuar ndihmë nga familja; pak gra kanë kërkuar ndihmë nga rrjete joformale dhe formale. Kështu, të mbijetuarat e DhNG-së nuk marrin mbrojtjen, shërbimet mbështetëse dhe aksesin në drejtësi siç ua garantojnë të drejtat e tyre të njeriut dhe ligjore. Çuditërisht, më pak gra kanë raportuar kërkim ndihme nga rrjete formale dhe joformale për dhunën në familje nga VKDhF-ja e vitit 2013 në VKDhNG-në e vitit 2018; nuk ka një shpjegim të qartë për këtë ndryshim.

RRUGA PËRPARA

Gjetjet nga VKDhF-ja e vitit 2007, VKDhF-ja e vitit 2013 dhe VKDhNG-ja e vitit 2018 tregojnë se DhNG-ja nuk është një çështje tangenciale

që prek vetëm jetën e disa grave dhe vajzave në Shqipëri; përkundrazi, DhNG-ja prek shumicën e grave dhe çon në ekspozimin e fëmijëve ndaj dhunës, veçanërisht në ato shtëpi ku fëmijët janë viktimë si të drejtpërdrejta dhe/ose jo të drejtpërdrejta të dhunës në familje. VKDhF-ja e vitit 2007, VKDhF-ja e vitit 2013 dhe VKDhNG-ja e vitit 2018 treguan gjithashtu se përdorimi/abuzimi me alkoolin nga ana e partnerit lidhet me përhapjen dhe shkallën e ashpërsisë së dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim si edhe me riskun e grave dhe seriozitetin e lëndimeve nga dhuna në familje.

Të dhënat nga VKDhF-ja e vitit 2013 dhe VKDhNG-ja e vitit 2018 tregojnë se një numër i madh grash kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale të ushtruar nga jopartneri, ose të dyja, që në moshën 15 vjeçare. VKDhNG-ja e vitit 2018 tregoi se gratë e ekspozuara ndaj dhunës nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare kishin risk më të lartë të përjetonin dhunë në familje të ushtruar nga partneri në moshë të rritur. Këto gjetje mbështesin gjetjet e studimeve ndërkombëtare që e lidhin dhunën e ushtruar nga partneri intim me dhunën në familje të ushtruar ndër breza.

Përprojekjet e INSTAT-it për të monitoruar modelet dhe tendencat në përhapjen e DhNG-së janë të rëndësishme dhe do të ndihmojnë Qeverinë e Shqipërisë, duke përfshirë hartuesit e politikave dhe vendimmarrësit, si edhe partnerët për zhvillim dhe ofruesit e shërbimeve për të vlerësuar ndikimin e reformave ligjore, zhvillimeve politike, mekanizmave të programimit dhe referimit që synojnë të përmirësojnë përprojekjet për parandalimin, mbrojtjen dhe ndërhyrjen dhe nismat për t'i dhënë fund DhNG-së.

Qeveria e Shqipërisë duhet të tregojë përkushtim ndaj mbledhjes së të dhënave për DhNG-në në vazhdimësi dhe rregullisht duke siguruar ekzistencën e mekanizmave të financimit për të mbështetur studimet e përhapjes së DhNG-së. Qeveria duhet të nxisë dhe financojë studimet për përhapjen e DhNG-së me përprojekje të bashkërenduar për të zbuluar informacion në lidhje me përvojat e grave me dhunën në familje të ushtruar nga partneri intim, dhunën gjatë marrëdhënies dashurore, dhunën e ushtruar nga jopartneri, ngacmimin seksual dhe përndjekjen. Këto vrojtime duhet të përsëriten së paku çdo pesë vjet për të matur zhvillimet me kalimin e kohës. Mbledhja e të dhënave duhet të mbështetet nga INSTAT-i dhe grupe të tjera ekspertësh sipas fushës, me mbështetje të vazhduar teknike nga organizatat ndërkombëtare.

**Ending
Violence**
Against
Women

